


QYTETARËT PËR NDRYSHIM

MAJ - GUSHT 2020 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.5



Што ни ја отежува соработката?

- Стереотипи: Приказната за вреќата пари и Мајка Тереза
- Генерализирање: профитерите и моралистите
- Различен јазик, не се разберат
- Различни очекувања
- Различно разбирање за соработка

Спечување судир на интереси

Документ со правила за спечување конфликт на интереси со кои располагаат ГО

60% 55%

7% 3%

Приходи 2018

бизнис сектор 1% физички лица 2% друга сопствена прихода 3% државна извора 1%

DREJTPËRDREJTË OSE ONLINE, ME RËNDËSI PUNA TË ECE

“Le të zbutet kjo çudia pak, e do të shohim” – kjo ishte një nga replikat e shpeshta gjatë muajve të kaluar, zakonisht e thënë në fund të bisedës telefonike. “Çudia”, gjegjësisht Covid-19, nuk kaloi, por na solli një verë të çuditshme. Përfundoi gjendja e emergjencës, disa masa u lehtësuan, disa qytetarë u relaksuan e “çudia” mori hov dhe në vend të pushimit mes valës së parë dhe të dytë, na solli një “valë të vazhduar të parë”, që sipas numrave ishte më intensive se gjatë kohës kur në orën 4 pasdite mbylleshim në shtëpi. U dorëzuam nga ndjekja e fiksuar e pres konferencave të ministrit të Shëndetësisë, dhe e zëvendësuam me pyetjen: “Sa janë sot?”, duke menduar në numrin e infektuarve të ri me Covid-19. Trinia e rekomanduar, maska, dezinfektim të duarve dhe distancë, për një pjesë të njerëzve u bë praktikë e rregullt, ndërsa “protokollet” e institucioneve, literaturë e detyrueshme.

Një pjesë e madhe e organizatave, ngadalë u kthyen në aktivitetet e rregullta të planifikuara. U intensifikua koordinimi i ndërsjellë, u përdorën përvojat nga muajt paraprak, kur i “vendosnim themelet” e punës online dhe u përshtatën aktivitetet për të ashtuquajturin normalitet i ri. Konferencat, debatet, trajnimet, mbledhjet u transferuan në Zum (ZOOM), Tims (Teams) dhe platformat tjera të ngjashme. Megjithatë diçka duhej, mund dhe zhvillohej “drejtpërdrejtë”, duke i respektuar masat për kujdes dhe siguri. Të tilla ishin aktivitetet e organizatave qytetare të cilat ndaj sfidës të quajtur Covid-19 u përgjigjën me distribuimin e ushqimit dhe produkteve higjienike, të dedikuara para së gjithash për mbështetje të kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve. Ata janë heronjtë e vërtetë të kësaj kohe.

Grantistët e Civika mobilitas nuk ishin përjashtim nga trendët. Grantet ad hok, të dedikuara për tejkalimin e kushteve emergjente të shkaktuara nga Covid-19 mundësuan përgjigje të shpejtë të organizatave për grupet qëllimore të tyre. “Edna moze”, Romalitiko, HOPS dhe “Eden” punuan në gjetjen e nevojave, koordinimin dhe distribuimin e ndihmës humanitare për familjet me një prind, familjet nga komuniteti rom, personave që përdorin droga, punëtorët seksual, fëmijët të cilët përdorin droga, të familjeve të tyre etj. Pandemia e intensifikoi nevojën nga mbështetja psiko-sociale, e

kështu Interaktiv dhe Vej kap realizuan aktivitete për qasjen e të rinjve dhe qytetarëve tjerë deri te mbështetja e këtillë përmes veglave digjitale. Qendra e krizës “Nadezh” punoi me gratë viktime të dhunës familjare, që u intensifikua gjatë gjendjes së emergjencës, ndërsa Sumnal punoi me nxënësit deri në klasën e pestë dhe u ndihmonte t’i tejkalonin problemet e shkaktuara nga mësimi në distancë. Me përshtatjen në kushtet e reja u realizuan edhe aktivitetet e grantistëve tjerë.

Rezultatet nga aktivitetet e grantistëve të Civika mobilitas dhe në përgjithësi të organizatave qytetare, nuk maten vetëm me tonë ushqim, produkte higjienike ose orë të kaluara në mësim, diskutime dhe inkurajimin e shfrytëzuesve. Ato maten në kënaqësinë e prindërve të cilët kanë çka t’ju japin për të ngrënë fëmijëve të tyre, në barrën e hequr nga kurrizi i tyre, në ndjenjën se ka dikush që ka menduar për ata dhe u ndihmon kohë pas kohe, në mirëqenien e atyre të cilët kanë arritur t’u shmangen dhunësve dhe kanë gjetur strehim të sigurt, në perspektivat e reja që u janë hapur njerëzve dhe vetëbesimin që e kanë fituar. Ndoshta nuk flasim aq shpesh për këtë, por jemi krenar se jemi pjesë e zgjidhjeve të problemeve të tyre pa dallim nëse janë lidhur me Covid-19 ose me gjendjet e shkaktuara nga diçka tjetër.

Në numrin e pestë të Qytetarët për ndryshime mund të gjeni përmbajtje interesante për fushatën “Mos vendos bast në jetën tënde” të Shoqatës së punëtorëve social, për modelin e suksesshëm për mobilizimin e mjeteve me të cilat ndërtohen shtëpi për bashkëqytetarët e varfër të shoqatës “Projekti lumturi”, për hulumtimet e “Megjashit” lidhur me qëndrimet e prindërve për organizimin e mësimi në vitin e ri shkollor, për betejën e qytetarëve të Gostivarit për ajër të pastër dhe shumë të tjera.

Lexim të këndshëm!

Gonce Jakovleska
Koordinator kombëtar i
Civika mobilitas për IKO

TEMA
**AMBIENTI
MUNDËSUES**

Saga për mbështetje nga shteti për organizatat qytetare në mes të krizës nga Covid-19

Vendimi i Qeverisë nga 9 prilli që në mënyrë drastike ta zvogëlojë mbështetjen financiare për organizatat qytetare, shkaktoi reagime të shumta në opinion. Në këtë mënyrë u zvogëluar mbështetja e domosdoshme për rreth 525.000 euro, që na bënë me dije se shteti e përjashtoi shoqërinë civile si partner relevant në përballje me krizën e shkaktuar nga epidemia Covid-19.

Në reagimin e bashkuar, 72 organizata qytetare akuzuan se ky proces është jo transparent dhe se aspak nuk janë këshilluar para se të publikohen ndryshimet. Ata theksuan se pikërisht shoqatat ishin ato që ndër të parat iu përgjigjën krizës dhe në mënyrë aktive punojnë në sanimin e dëmeve nga gjendja e krizës, me çka i ndihmojnë Qeverisë në ballafaqimin me situatën e porsakrijuar. Ata i bënë thirrje Qeverisë që t'i kthejë një pjesë të mjeteve për qëllimin e tyre parësor, por edhe të alokojë mjete për ballafaqimin me krizën.

Qeveria iu përgjigj organizatave më 5 qershor, kur e miratoi Vendimin për kriteret dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për realizimin e Programit për financim të aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për masat për ballafaqimin me krizën e COVID-19. Thirrja u publikua më 6 qershor dhe zgjati deri më 11 qershor 2020. Edhe pse afati ishte i shkurtër, numri i aplikimeve të arritura ishte 549. Vlerësimi u realizua në afat edhe më të shkurtër prej dy ditëve. Në këtë mënyrë u zgjodhën 40 projekte të shoqatave dhe fondacioneve, me vlerë të përgjithshme prej 29.519.495 denarë. Në Komisionin për zgjedhje, krahas pesë anëtarëve të cilën vinin nga Qeveria, u emëruan edhe dy anëtarë të Këshillit për bashkëpunim.

Afatet e shkurta për paraqitje, e veçanërisht për vendimmarrje ishin një nga pikat kryesore të kritikës nga ana e organizatave. Qeveria, përmes kumtesës u arsyetua se opsioni tjetër për afatet e shkurta ishte që mos të sigurohet ndihmë aspak dhe këto mjete të humben.

“Secili nga vlerësuesit i ka vlerësuar individualisht të gjitha aplikacionet e arritura për 36 orë. Kjo do të thotë

se për secilën prej tyre, ka shqyrtuar nga një aplikacion për projekt për 4 minuta e 40 sekonda, të njëjtën e ka bërë pa ndërprerje 36 orë, pa asnjë orë pushim”, qëndron në vërejtjen e Këshillit Rinor Kombëtar të Maqedonisë. Ata janë një nga mbi 50 organizatat të cilat reagojnë për raportin joparimor të Qeverisë ndaj sektorit civil.

Shoqatat u ndanë rreth kësaj çështje që shkaktoi ndarje mes tyre. Të pakënaqurit nuk gjetën mirëkuptim nga ana e Qeverisë. Aktivitetet vazhduan sipas planit, gjegjësisht, më 19 qershor u nënshkruan marrëveshjet me fituesit, në bazë të cilës më 1 korrik u transferuan mjetet.

VMRO-DPMNE dhe Koalicioni “Përtëritja për Maqedoninë” akuzuan se shpërndarja e mjeteve gjatë fushatës parazgjedhore në të vërtetë është mitë dhënie dhe parashtruan kundërshtim deri te Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK). Ky kundërshtim u miratua nga ana e KSHPK, por Gjykata administrative e hodhi poshtë vendimin e tyre dhe kundërshtimin e refuzoi si të pabazë.

“Është e saktë se nuk mund të bëhen pagesat e lartpërmendura nga mjetet buxhetore, por pas gjetjeve të kësaj Gjykate, në rastin konkret është bërë pagesë e mjeteve nga Buxheti i RMV, për çka janë miratuar vendime dhe Programi për dhënie të mbështetjes financiare, në gjendje emergjence, ndërsa pagesa paraqet vetëm realizim i këtyre vendimeve dhe programeve”, qëndron në vendimin.

Sabina Fakiq, nga Qendra për komunikime qytetare dhe anëtar i Këshillit për bashkëpunim, mendon se shoqatat nuk është dashur të ndahen dhe të lejojnë që shoqëria civile të vendoset në kontekst negativ. “Në kushte të pandemisë, besoj se të gjithë e dini se mbështetje financiare fituan edhe mediat. Nuk dëgjuam se mbështetja financiare për ata ndërlihet me mitë dhënie parazgjedhore. Por dëgjuam diskreditim maksimal të organizatave qytetare, edhe të atyre që kanë fituar edhe të atyre që nuk kanë fituar. Do të pajtoheni se kjo është diçka në llogari të gjithë neve”, përfundoi Fakiq.

Fituesit e zgjedhur të granteve

Reagim i një pjese të organizatave qytetare

Pakënaqësi nga Vendimi i Qeverisë për ndarjen e mjeteve shtetërore, një pjesë e organizatave qytetare e manifestuan me ankesë dhe reagim deri te Qeveria dhe ish kryeministri teknik Oliver Spasovski dhe Këshilli për bashkëpunim me dhe zhvillimin e sektorit civil. Ata dërguan informatë edhe deri te kryetari Pendarovski dhe deri te Delegacioni i BE në Shkup. Nga Qeveria kërkuar përgjigje për disa pyetje, të cilat kishin të bëjnë me

kriteret, ndërsa lidhur me regjistrimin e organizatave fituese dhe konfliktin e mundshëm të interesave. Në të vërtetë, sipas njohurive të tyre, te një pjesë e fituesve anëtarë janë funksionarë shtetëror.

Qeveria nuk u përgjigj reagimeve të organizatave. Në periudhën e ardhshme, ata planifikojnë ta vëzhgojnë zbatimin e projekteve dhe organizatat të cilat fituan mbështetje financiare nga Qeveria.

Raport për praktikat drejtuese dhe transparencën e shoqatave

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) e përgatiti **Raportin për praktikat drejtuese për transparencë dhe llogaridhënie të organizatave qytetare**, me qëllim që të shqyrtohen praktikat vijuese në vend.


Mes pikave të cilat u identifikuan ishin: strukturat drejtuese, ndarja e funksioneve të organeve në organizatë, mënyra e vendimmarrjeve, puna organizative dhe administrative, parandalimi i konfliktit të interesave, puna financiare, udhëheqja me resurset njerëzore, praktikat për raportim, vëzhgim dhe inkuadrimin e anëtarësisë.

Një nga sfidat më të mëdha është ndarja e dobët e funksioneve ekzekutive dhe drejtuese në praktikë, gjegjësisht shpesh ndodh që personat e njëjtë të jenë anëtarë në dy organet. Kështu për shembull, 56% të organizatave janë përgjegjës se të punësuarit, duke përfshirë edhe drejtorin ekzekutiv, janë anëtarë të organeve drejtuese me të drejtë vote. Po ashtu, më shumë se gjysma e organizatave kanë strukturë të dyfishtë të organeve drejtuese, që përfshinë Kuvendin dhe Këshillin, ndërsa te 41% haset një nga këto organe.


Pjesa më e madhe e organizatave qytetare në Statutet e tyre e kanë inkorporuar rregullën për parandalimin e konfliktit të interesit (55%), por më shumë se një e katërta (27%) akoma nuk i kanë përcaktuar rregullat e tilla. Po ashtu, vetëm një e pesta kanë politikë të shkruar për barazinë gjinore dhe diversitetin, që e hap çështjen për përpjekjet për përfshirjen gjinore dhe përfaqësimin e organizatave qytetare në suaza të anëtarësisë së tyre dhe resurseve të angazhuara njerëzore.

Një nga gjetjet flet për atë se shoqatat kanë rregulla dhe procedura jo aq të zhvilluara për menaxhim me resurset njerëzore. Edhe pse 56% të organizatave qytetare kanë personel të punësuar me orar pune të pacaktuar ose të caktuar, vetëm një e treta (33%) prej tyre kanë rregullore për menaxhim me resurset njerëzore. Përveç kësaj, edhe pse pjesa më e madhe e organizatave bazohen në anëtarësi, megjithatë 67% nuk e përdorin “tërheqjen e anëtarëve të ri në nivel vjetor” si indikator për efikasitet dhe efektivitet në punë.

Rekomandimet nga Raporti kanë të bëjnë me atë që organizatat t'i përjashtojnë drejtorin ekzekutiv dhe të punësuarit nga votimi në organin drejtues (jo ekzekutiv); të zhvillojnë kriteret dhe kompetencat të qarta që duhet t'i posedojnë anëtarët e Këshillit drejtues; të zhvillojnë plan konkret për monitorim dhe evaluim të strategjisë organizative; të zhvillojnë rregulla dhe procedura për udhëheqje me resurset njerëzore.



Органи на управување/раководење во граѓанските организации



Извор: Извештај за управувачките практики, за транспарентноста и отчетноста на граѓанските организации, 2020, МЦМС

Raport për ambientin mundësues për vitin 2019

“Në vitin 2019 kishim një ambient relativisht mundësues për shoqërinë civile. Mund të theksojmë se organizatat qytetare ishin të përfshira në konceptimin e teksteve të një pjese të ligjeve më të rëndësishme, për shembull Ligji për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave, Ligji për mbrojtje social, Ligji për ndihmë juridike pa pagesë dhe tjera”, tha Snezhana Kamillovska Trpovska nga MCMS, lidhur me **Raportin për ambient mundësues për zhvillim të shoqërisë civile për vitin 2019**.

Kamillovska potencoi se edhe në përgjithësi krahas gjetjeve të mira, mungon përfshirja e organizatave qytetare në fazat e hershme të procesit të krijimit të politikave, e jo kur ato janë më në formë të propozim gjegjësisht draft-tekstit të ligjit.

Sipas gjetjeve nga Raporti, ndihma shtetërore për shoqërinë civile për vitin 2019 jo vetëm që nuk është rritur, ashtu siç ishte rekomanduar, por është zvogëluar për 13% në raport me vitin 2018. Edhe pse ishte paralajmëruar reformim gjithëpërfshirës të modelit për financim shtetëror, megjithatë nuk ka ndryshime të mëdha në këtë fushë.

Gjatë vitit 2019 ndodhën një sërë ngjarjesh, të cilat e rritën transparencën dhe llogaridhënien e procesit të shpërndarjes së mjeteve publike të OQ. Në të vërtetë, për herë të parë institucionet shtetërore dorëzuan të dhëna për shpërndarjen e mjeteve të OQ në nivel kombëtar dhe lokal, ndërsa po ashtu Ministria e Financave i publikoi emrat e pranuesve të mjeteve në ueb faqen Financimi i hapur.


Një pjesë e risive është edhe ndryshimi i Ligjit për tatim të vlerës së shtuar (TVSH), me të cilin u bë më i volitshëm për shoqatat. Në të vërtetë, me ndryshimin, tatimpaguesit janë të obliguar që të regjistrohen si obligues të TVSH-së nëse qarkullimi i përgjithshëm në vitin e kaluar kalendarik e tejkalon vlerën prej 2 milionë denarë ose qarkullimi i përgjithshëm i të cilëve pritet ta tejkalojë këtë vlerë gjatë vitit. Pragu paraprak prej 1 milion denarë paraqiste barrë për organizatat të cilët planifikonin të inkuadrohen në aktivitet ekonomik.

Rekomandimet nga Raporti kanë të bëjnë me harmonizimin e rregullativave të reja ligjore me ato ndërkombëtare (konkretisht për propozim ligjin për lobim dhe për tubime publike); reformimi gjithëpërfshirës i financimit shtetëror për shoqatat; inkuadrimi i hershëm i organizatave në proceset konsultative; etj.



Има пристап до релевантни информации пред одржување на консултациите (пр. нацрт текст на закони, подзаконски акти, анализи, мислења од други институции, итн)

Организациите се вклучени во рана фаза на подготовка на законодавство и политики.



A hand holding a paper airplane against a teal and yellow gradient background. The hand is positioned in the lower center, with the fingers gripping the body of the plane. The paper airplane is white and is angled upwards towards the top right. The background is a smooth gradient, transitioning from a light yellow at the bottom left to a deep teal at the top right.

LAJME
NGA
SHOQËRIA CIVILE

BASHKËPUNIMI

U ndërtua shtëpia e parë nga projekti “Shtëpia e ngrohtë” e shoqatës “Projekti lumturi”

Organizata “Projekti lumturi” (Proekt sreka) është një nga shembujt më të suksesshëm për mobilizimin e fondeve nga komuniteti. Ata në shkurt filluan me ndërtimin e shtëpisë për familjen Simonovski, ku janë anëtarë babai i vetëm me pesë fëmijët e tij dhe ka arritur ta përfundojë deri më 10 mars.

Prej “Projekti lumturi” thonë se situata në të cilën e kanë gjetur familjen ka qenë shumë e keqe. Fëmijët flinin në dyshe, pa instalime elektrike ose të ujit, ndërsa shtëpia më shumë i ngjante karabinës. Falë donatorëve kryesor Kazinosë “Senator” dhe hotelit “Paint it Black” nga Gjevgjelia, fëmijët për herë të parë kanë dhomë të tyre, shtretër, tualet, ujë, energji elektrike gjegjësisht kanë shtëpi të denje, ashtu siç e meriton çdo njeri.

Gjatë ndërtimit, kësaj iniciative i janë inkuadruar edhe kompani të tjera si donatorë, dhe falë kësaj, ndërtimi i përgjithshëm ka përfunduar mjaft shpejtë. Nga shoqata janë të kënaqur me rezultatin, si dhe nga realizimi i shpejt dhe profesional i iniciativës së tyre.

Përveç kësaj shtëpie, projekti “Shtëpia e ngrohtë” parasheh rikonstruimin dhe ndërtimin e 10 shtëpive, për familjet me fëmijë të cilët jetojnë në kushte jashtëzakonisht johumane dhe të vështira, pa kushte elementare për jetë. Ky është një nga projektet më të mëdha humanitare në vendin tonë, e për këtë qëllim apelojnë deri te të gjitha kompanitë ndërtimore, si dhe deri te të gjithë donatorët e interesuar që ta mbështesin dhe të kontribuojnë drejt ndryshimeve më të mëdha.



Reagim i shoqatave rreth pakos së tretë të masave ekonomike lidhur me COVID-19

“Pakoja e tretë e masave në vend të “dhuratave” të njëhershme, duhej të përmbajë ndryshime më të mëdha, sistemore, në drejtim të ndërtimit të shoqërisë më solidare, e cila më shumë do të kujdeset për punëtorët, punëtorët, të varfrit dhe të gjithë qytetarët pa të drejtë vote dhe që ju është bërë padrejtësi”, rekomandojnë pesë shoqata dhe gjashtë sindikata në reagimin ndaj pakos së tretë të masave nga Qeveria për ballafaqim me krizën të shkaktuar nga virusi korona.

Në këtë reagim, ata thanë se edhe pse Qeveria i ka informuar para thirrjes që të shpallet publikisht, ai as afër nuk është i harmonizuar me kërkesat e tyre, pasi që asnjë nga vërejtjet nuk është pranuar. Përveç kësaj, Qeveria nuk e ka respektuar marrëveshjen për personat të cilët e kanë humbur punën gjatë krizës. Sipas marrëveshjes, ata duhej të përfshihen me zgjidhje sistemore për sigurim në rast të papunësisë, gjegjësisht, të marrin kompensim për një periudhë kohore, që varet nga stazhi i tyre, e jo vetëm prej dy muajsh.

Reagimi është nënshkruar nga Konfederata e organizatave sindikale të Maqedonisë (KOSM), Sindikata e punëtorëve nga administrata, organet gjyqësore dhe shoqatat e qytetarëve (AOGJSH), Sindikata e pavarur akademike (SPA), Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve në media (SPGPM), Sindikata e kulturës të Republikës së Maqedonisë (SKRM), Sindikata e shërbimit diplomatik maqedonas (SSHDM), Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, Shoqata e qytetarëve “Tekstilisti i zëshëm”, Lëvizja e majtë “Solidariteti”, JADRO - Asociacioni i skenës së pavarur kulturore dhe Fronti subversiv.

Rikonstruimi dhe legalizimi i shtëpive të romëve të rrezikuar në Vinicë

Qendra resurse rome dhe ÇELIM nga Milanoja në bashkëpunim me Komunën e Vinicës vazhduan me aktivitete për avancimin e cilësisë së strehimit të romëve.

Ka filluar procesi i legalizimit të shtëpive të familjeve të rrezikuara sociale nga komuniteti rom. Ata një kohë të gjatë kanë probleme që t'i legalizojnë pronat e tyre, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Në këtë moment ka përfunduar legalizimi i 15 shtëpive të para. Në periudhën e ardhshme do të punohet në legalizimin edhe të 40 lëndëve. Me këtë, këto familje do të marrin vendim për legalizim dhe certifikatën e pronësisë për shtëpitë e tyre. Gjatë zbatimit të projektit duhet të zgjidhen problemet me legalizimin për gjithsej 255 amvisëri dhe t'u sigurohen certifikatat e pronësisë.

Përveç kësaj, tashmë po rinovohet shtëpia e shtatë prej gjithsej 22. Në periudhën e ardhshme vijon rikonstruimi i 15 shtëpive tjera. Këto aktivitete zbatohen në suaza të

projektit “Sigurimi i kushteve me dinjitet për strehim për komunitetin rom në Komunën e Vinicës – SDH”, të financuar nga Bashkimi Evropian.



Bashkëpunim për funksionim më të mirë të sistemit të probacionit

Nëntë organizata qytetare aktive në fushën e probacionit, sundimin e të drejtës, transparencës dhe drejtimin e mirë, para do kohe e themeluan Koalicionin për probacion. Anëtarë të saj janë: Organizata qytetare për të drejtë, politikë, edukim dhe media, Proficio, “Zelena Lupa”, In vivo dhe Tek bal market nga Shkupi, LGBT Junajted nga Tetova, Zëri inicial nga Prilepi, Organizata e Grave të Strumicës dhe Inkluzioni nga Ohri.

“Themelimi i Koalicionit për probacion është iniciuar nga “Zelena Lupa”, si pjesë e aktiviteteve të projektit “Jetësimi i ligjit për probacion në nivel lokal përmes partneriteteve efikase në Komunën e Strumicës”, që e realizon bashkë me Organizatën e Grave të Strumicës, me mbështetje financiare të Civika mobilitas”, na tha Katerina Babullova nga “Zelena Lupa”. Ajo theksoi se koalicioni ka tendencë që përmes bashkëpunimit të ndërsjellë të organizatave qytetare dhe aktorëve kyç, të detektohen fushat kritike dhe dobësitë e zbatimit të masave për probacion dhe të përmirësohet sistemi i probacionit në tërësi. Prioriteti kryesor është që me sukses të risocializohen dhe riintegrohen personat e dënuar në shoqëri.

“Përvojat tona në Strumicë janë pozitive”, thotë Babullova, “ato do t'i transferojmë te partnerët tonë të Koalicionit. Ideja jonë është që të gjithë të trajnohen që t'u japin mbështetje të drejtpërdrejtë personave, të cilët do t'i shfrytëzojnë masat për probacion. Pastaj, ata në nivel lokal

do të punojnë me persona të dënuar duke i këshilluar, informuar për obligimet ligjore, udhëzimin drejt shërbimeve adekuate që me sukses të mund të zbatohen masat e probacionit dhe të kontribuohet për integrimin e tyre efikas dhe risocializimin në shoqëri”.

Koalicioni ka vendosur më shumë synime para vetes: rritja e interesimit për aplikimin e masave për probacion; kontribut drejt rritjes së besimit publik në sistemin e probacionit; identifikimin e problemeve në sistemin e probacionit dhe shprehjen e nevojës për reforma juridike dhe institucionale; njohja e opinionit me standardet dhe të drejtat për probacion dhe forcimin e besimit të qytetarëve në funksionimin e sistemit të probacionit; zvogëlimi i mundësive për trajtim joadekuat të institucioneve ndaj shfrytëzuesve të masave të probacionit dhe sigurimin e qasjes së barabartë deri te drejtësia përmes ofrimit të ndihmës juridike pa pagesë.

Koalicioni është i hapur për anëtarë të ri, me të cilët do t'i mbulonin të gjitha qytetet ku funksionojnë burgjet. Babullova beson se bashkarish kanë vullnet dhe forcë që ta shtynë zbatimin e Ligjit për probacion, i cili është në fuqi ka pesë vite, por rezultatet prej tij janë më shumë se modeste.

Inspektorët komunal më shumë i mbrojnë të fuqishmit se sa qytetarët

Sipas Anketës për punë të inspektorëve komunal dhe Hulumentit “**Inspektorët komunal – problemet dhe sfidat**” të OJQ Infoqendra, mbi dyzet për qind të anketuarve mendojnë se inspektorët në punën e tyre varen nga kryetarët e komunave. Pothuaj po aq qytetarë mendojnë se inspektorët komunal nuk janë profesionistë dhe efikas, si dhe se në vend që t’i mbrojnë qytetarët dhe interesin publik, i mbrojnë interesat e politikanëve dhe të fuqishmit në biznes.

Banorët e Regjionit të Shkupit, personat me arsimim të lartë dhe ata të moshës prej 35 deri 44 vjet janë mbrojtësit më të mëdhenj të tezës se inspektorët varen nga vullneti i kryetarëve të komunave.

Shumë pak qytetarë (më pak se 10 për qind) kanë deklaruar se ata ose ndonjë i afërm i tyre ka paraqitur problem të inspektori përkatës komunal. Pothuaj dy të tretat e atyre të

cilët kanë paraqitur problem në komunë janë të pakënaqur nga përvoja dhe veprimi i inspektorëve lokal.

Një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen inspektorët janë rrogat e ulëta dhe kompensimet, të cilat nuk janë adekuate me profesionin e tyre. Gjatë punës në terren, ata nuk kanë pajisje adekuate për mbikëqyrje, automjete për terren, aparate për matjen e zhurmës, rroba mbrojtëse etj., që kontribuon mos të ndjehen të sigurt.

Sipas hulumentit, komunat shpesh veprojnë pas paraqitjeve dhe parashtesave të qytetarëve në periudhën prej një jave deri në një muaj. Një nga arsytet për procesin e ngadalshëm është numri i pamjaftueshëm i inspektorëve, si dhe procedurat e gjata dhe të ndërlikuara ligjore dhe administrative gjatë mbikëqyrjes së inspektimit.

“Megjashi” hulumtoi çfarë mendojnë prindërit lidhur me mësimin në vitin e ri shkollor

Në prag të fillimit të vitit shkollor, Ambasada e parë e fëmijëve në botë “Megjashi” i hulumtoi **qëndrimet dhe përvojën e prindërve/kujdestarëve lidhur me metodat e organizimit të procesit arsimor të fëmijëve në vitin shkollor 2020/2021**.

Rezultatet treguan se më shumë se dy të tretat e prindërve/kujdestarëve (68,7% të anketuarve) do të pranonin mësim të kombinuar, gjegjësisht mësim me prezencë fizike dhe online. Diçka më shumë se gjysma e të anketuarve (52,4%) do të nënshkruanin pëlqim që fëmija/fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë çdo ditë, për dallim nga 26,9% të anketuarve të cilët nuk do ta nënshkruanin pëlqimin derisa zgjat pandemia me Covid-19. Në pyetjen rreth asaj se si duhet të organizohet mësimi, dominojnë propozime për mësim online dhe të kombinuar.

Duke pasur parasysh se gjatë mësimin online nxënësit kanë nevojë për mbështetje më të madhe nga prindërit, me këtë hulumtim u verifikuan edhe këto qëndrime. Rreth gjysma e të anketuarve (49,9%) kanë thënë se pjesërisht kanë kohë dhe mundësi që t’u ndihmojnë fëmijëve të tyre në mbizotërimin e përmbajtjeve mësimore, derisa 16,7% kanë thënë se nuk mund d.m.th. nuk kanë kohë dhe mundësi që t’u ndihmojnë fëmijëve të tyre gjatë mësimin.

Sa i përket përvojave nga mësimi online në vitin paraprak shkollor, pothuaj gjysma e të anketuarve (47,3%) mendojnë se ai vetëm pjesërisht i ka plotësuar nevojat e nxënësve. Vetëm 3,7% pikë të përqindjes është dallimi me ata të cilët mendojnë se online mësimi i deritanishëm aspak nuk i ka plotësuar nevojat e nxënësve. Shumica e të anketuarve (58,2%) mendojnë se fëmijët e tyre përmes mësimin online kanë fituar nota më të mira, por me më pak njohuri. Një nga pengesat gjatë mësimin online janë kushtet teknike me të cilat disponojnë familjet. Të pyetur rreth kësaj, pothuaj dy të tretat (64,3%) të anketuarve kanë deklaruar se kanë kushte adekuate hapësinore teknike për ndjekjen e mësimin online, 28,7% vetëm pjesërisht, ndërsa 6,4% aspak nuk disponojnë me kushte adekuate hapësinore dhe teknike për ndjekjen e mësimin online.

Hulumtimi u zbatua përmes anketës, ku ishin përfshirë 1003 të anketuar. Anketa u realizua përmes Internetit në periudhën prej 22 korrikut deri më 3 gusht 2020.



Ndarja e njohurisë është thelbësore për ndërtimin e sektorit modern publik


Sektori privat ka vendosur përvoja më të avancuara për ruajtjen e njohurisë, që u mundëson të jenë më efikas dhe më të efektshëm dhe u jep përparësi konkurruese. Kjo nuk ndodh te sektori publik ose të paktën me pjesën më të madhe të tij, ka treguar hulumtimi i Qendrës për menaxhim me ndryshime (QMN) me titull “Ndërtimi i sektorit publik të bazuar në njohuri”, kushtuar verifikimit të praktikave për ruajtjen dhe ndarjen e njohurive në sektorin privat dhe publik.

Gjetjet nga përgjigjet e fituara treguan se 74% të institucioneve, dokumentet të cilat i punojnë çdo ditë, i ruajnë në disk lokal, në kompjuterët në të cilët punojnë, derisa rreth 16% i ruajnë në folder të përbashkët. Në këtë folder, vetëm 19% të rasteve kanë qasje të gjithë të punësuarit, derisa në 50% të rasteve nevojitet qasje e miratuar ose autorizim për përdorimin e folderit të përbashkët. Sa i përket ndarjes së njohurive, një përqindje e lartë prej 84% kanë deklaruar se institucionet e tyre nuk kanë procedura të brendshme ose rregulla tjera me të cilat kjo rregullohet. Kjo tregon se në këto institucione është anashkaluar koncepti i njohurisë dhe memories institucionale, që në kushte të funksionimit të rregullt, e veçanërisht gjatë punës nga distanca, siç është rasti gjatë periudhës së pandemisë, duhet të kontribuojë për kënaqësinë dhe besimin nga qytetarët.

“Ideja jonë nuk ishte ta kritikojmë administratën, por të tregojmë se nëse krizat e këtilla vazhdojnë të na ndodhin, gjegjësisht kriza vazhdon, ne duhet t'i përshtatim proceset dhe të jemi funksional edhe nga shtëpia”, tha Neda Maleska Saçmaroska, drejtoreshë ekzekutive e QMN. Ajo theksoi se fjala është për dokumente të cilat i prodhojnë të punësuarit, hulumtime, të dhëna për shfrytëzuesit e subvencioneve etj., në bazë të cilave mund të ndiqen trendët dhe të shfrytëzohet kjo njohuri për krijimin e politikave më të mira. “Kur të punësuarit largohen nga

institucionet, praktikisht shkon edhe njohuria me ata. Nëse ka fluktacion të madh të kuadrove, memoria institucionale bëhet edhe më e rëndësishme” shtoi ajo.

Debatet për administratën publike, veçanërisht për efikasitetin e saj, asnjëherë nuk kanë pushuar, gjendja aktuale me pandeminë e shkaktoar nga virusi korona edhe më shumë i potencoi. Pamundësia që punëtorët administrativ të funksionojnë jashtë zyrave të tyre e rriti pakënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet e institucioneve. Prej QMN thonë se kjo është reflektuar edhe te hulumtimi i tyre, gjegjësisht në numrin e përgjigjeve të kërkesave të tyre për qasje deri te informatat me karakter publik.



Turbulenca të reja rreth Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi

Pak para zgjedhjeve të dhjeta të parakohshme parlamentare, 17 parti politike e nënshkruan deklaratën për sjellje me prioritet ndaj Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, e cila vijoi me kërkesë të nëntë rrjeteve të organizatave qytetare të cilat gjithsej numërojnë mbi 100 shoqata.

“Qëllimi i Deklaratës është që partitë politike të obligohen se këtë Ligj do ta miratojnë menjëherë pas formimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa prolongime shtesë dhe se pastaj, në pëlqim me afatet

ligjore, do ta zgjedhin përbërjen e re të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ky ligj e mbron të drejtën për barazi të qytetarëve të garantuar me kushtetutë, parasheh procedura për mbrojtje nga diskriminimi, ndërmarrja aktive e masave për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë për të gjithë qytetarët, e veçanërisht të grupeve të marginalizuara”, thonë nga shoqatat.

Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi e miratoi përbërja paraprake parlamentare më 16 maj

2019, por Gjykata kushtetuese e pezulloi me vendim, i cili u miratua në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2000. Vendimi erdhi me iniciativë të parashtruar nga ana e përbërjes paraprake të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të Ligjit, pasi që ligji është miratuar pa shumicën e nevojshme, që është rregulluar me nenin 75 të Kushtetutës.

Siç informoi ish ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, “me këtë vendim nuk kthehet në jetë ligji paraprak, ndërsa pezullohet ligji i ri nga viti 2019”. Kjo do të thotë se qytetarët janë lënë pa Komision, gjegjësisht pa trup zyrtar

për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi mbi të gjitha bazat.

Iniciatorë të deklaratës janë: Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi (RRMD), Rrjeti kombëtar për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë (RRKHT), Platforma për barazi gjinore, Platforma maqedonase kundër varfërisë (PMKV), Rrjeti 23, Rrjeti joformal i organizatave rome, Grupi Blueprint për reforma në legjislacion, Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit dhe Platforma për qëndrueshmëri të serviseve për parandalim dhe mbështetje për HIV.

Korrupsioni gjatë punësimit të personave me aftësi të kufizuara

Shoqata “Polio plus” në qershor organizoi konferencë, në të cilën u diskutua për praktikën e korrupsionit, me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara gjatë punësimit të tyre. Sipas hulumtimit të cilin e zbatoi shoqata, një pjesë e madhe e këtyre personave janë të painformuar ose të pa interesuar për keqpërdorimin e këtillë, që është pasojë e përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara nga krijimi i politikave të cilat i prekin ata.

Elena Koçoska, koordinatore e projektit në “Polio plus”, theksoi se arsimimi i ulët dhe mungesa e kualifikimeve për pjesëmarrje në politika, mund të jetë shkak për personat me aftësi të kufizuara të lihen anësh nga proceset e krijimit të politikave, por mendon se megjithatë problemi më i madh është pa interesimi nga ana e të prekurve.

Nga diskutimi i pjesëmarrësve u përfundua se institucionet përkatëse duhet të ndihmojnë më shumë, por personat me aftësi të kufizuara janë ata të cilët duhet të jenë më aktiv dhe më të guximshëm në luftën kundër keqpërdorimeve.

Edhe një aspekt i cili u përfshi është qasja deri te institucionet si faktor që sjell deri te korrupsioni dhe jo konsekuentja. Krahas pengesave fizike, personat me aftësi të kufizuara përballen edhe me pengesa burokratike. Slobodan Ivanov, anëtar i “Polio plus” e ndau përvojën e tij nga procedura për grumbullimin e dokumentacionit për punësim, që ka zgjatur disa muaj.

Ky aktivitet është pjesë e projektit të Polio plus, me të cilën bëhet ndërgjegjësimi dhe njohja e korrupsionit gjatë punësimit të personave me aftësi të kufizuara.



Eko mëhalla – loja e parë edukative për shoqërim për efikasitet energjetik

Shoqata e qytetarëve “Eko logjik” e përgatiti lojën e parë edukative në vend, e cila ka të bëjë me efikasitetin energjetik dhe burimet e përtëritshme të energjisë. Në “Eko mëhallën” më me rëndësi është ndërtimi i mjedisit të pastër jetësor. Përmes shfrytëzimit të mjeteve të ndryshme transportuese dhe zbulimin e fakteve të reja interesante për burimet e përtëritshme të energjisë, lojtarët lëvizin në rrugë drejt cakut, që është plot sfida të ndryshme.

“Do të keni mundësi të investoni në pikë, të cilat fitohen vështirë, me qëllim që të kurseni energji përmes dritave të kursyese, dritaret energjetike-efikase, panelet diellore dhe izolimi për shtëpinë. Rruga drejt cakut është plot me shumë interaksion dhe zbavitje”, thonë krijuesit e lojës.

Loja është e kapshme në platformën online “Tebtopia” deri te e cila mund të arrihet përmes celularit dhe kompjuterit. E destinuar për fëmijët e moshës mbi 10 vjet dhe mund të luajnë dy deri më së shumti katër persona. Për adhuresit e lojërave klasike për shoqërim, janë cekur edhe udhëzimet për lojën, për rekreacion në kushte shtëpiake me letër ose karton.

Shoqata “Eko logjik” punon në përmirësimin dhe avancimin e problemeve të ndryshme sociale dhe sfidave përmes temave të cilat nuk janë të përfaqësuara në mësimin e rregullt shkollor, ndërsa ka rëndësi të madhe për zhvillimin e drejt moral, social, fizik dhe ekologjik të fëmijëve. Një shembull i tillë është projekti “Velo poligon”, të cilin e zbatojnë me mbështetje të Civika mobilitas, ndërsa ka të bëjë me avancimin e njohurive të fëmijët dhe prindërit e tyre për përfitimet nga çiklizmi, transporti i qëndrueshëm, ndotja e ajrit dhe siguria në komunikacion.




Fushatë “Mos vendos bast në jetën tënde”

Varësia nga basti sportiv dhe lojërat tjera të fatit janë një nga problemet e të sotmes, që janë mjaft të përhapura mes të rinjve. Sipas analizës së kryer nga Asociacioni i bastoreve sportive në vend në vitin 2013, 46% të qytetarëve pse 61% të meshkujve vënë bast, pothuaj tre të katërtat prej tyre kanë të paga mesatare. Në vendet me standard të ulët jetësor, si vendi ynë, bixhozi nuk është vetëm zbavitje, por shpesh kjo kalon në varësi. Që të ngritët vetëdija për trajtim adekuat, Shoqata e punëtorëve social të Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me Shoqatën e klubeve të alkoolistëve të mjekuar të Republikës së Maqedonisë e nisën fushatën “Mos vendos bast në jetën tënde”. Projekti është mbështetur nga Civika mobilitas me grant veprimi.

Anketa e zbatuar nga shoqatat me ekzemplar prej 4.000 nxënësve të shkollave të mesme tregoi se 69% të nxënësve të paktën një herë kanë luajtur ndonjë lojë fati, e shpesh fjala është loto dhe basti sportiv. Më me rëndësi është të përmendet se 20% të anketuarve ndonjëherë ose rregullisht vendosin bast para se të dalin në mbrëmje. Sjellja e këtillë brengos pasi që këta nxënës i konsiderojnë

lojërat e fatit si burim për fitim të shpejtë, që më tej lehtë mund të krijohet varësi dhe me vete të sjelle edhe probleme tjera sociale, psikologjike dhe mjekësore. Lidhur me atë se sa janë të njoftuar prindërit se fëmijët e tyre vendosin baste, përgjigjet janë të ndara. Gjithsej 43% janë deklaruar se prindërit janë të njoftuar, 34% janë përgjigjur se prindërit e tyre nuk e dinë, derisa 12% nuk janë të sigurt nëse prindërit e tyre janë të vetëdijshëm për vendosjen e basteve.

Për shkak të ndërgjegjësimit dhe promovimit më të gjerë të linjës telefonike për ndihmë nga varësia, shoqatat përgatitën fushatë mediatike me tre video spote. Në këtë mënyrë u dërguan mesazhe të fuqishme për pasojat nga lojërat e fatit për familjet, miqtë, karrierën dhe shëndetin. Një nga mesazhet kishte të bëjë edhe me justifikimet e shpeshta të personave të varur, duke folur për faktin se vetë ata nuk janë të vetëdijshëm se kanë problem me bastet, por se këtë e bëjnë vetëm për shkak të zbavitjes, ose se mund ta ndërpresin këtë kur të dëshirojnë.



Shoqatat rekomandojnë se nevojiten masa parandaluese me të cilat të rinjtë në mënyrë më intensive do të informohen për këtë varësi, e po ashtu mendojnë se komuniteti lokal ka rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin. Një nga rekomandimet e tyre ka të bëjë me hapjen e këshillimoreve për ndihmë dhe mbështetje të rinjve që ballafaqohen me këtë problem dhe për anëtarët e familjeve të tyre.

U përzgjodhën fituesit e garës “Idetë e gjelbra”

Shoqata e novacioneve sociale ARNO i shpalli fituesit e garës së sivjetme “Idetë e gjelbra”, që kësaj radhe u mbajt online. Për idetë më të mira të zgjedhura “Vajs aditiv” e Vajs Grup SHPK – Shkup, “Miqte e bletëve” të Shoqatës Grupi themelor i bletarëve të regjionit të Bregallnicës “Meden Istok”, si dhe “Mbrotja e fenomenit të kolbarit në Maqedoni dhe promovimi i specialiteteve tradicionale të Maleshevisë” të Dushica Krstevska nga Berova. Këto ide do të vazhdojnë të luftojnë në nivel regional për çmimin prej 10.000 dollarë. Deri tani vendi ynë ka pasur gjashtë fitues dhe investim të përgjithshëm prej 60.000 dollarë për zhvillimin e biznes ideve.

Për fituesit kombëtar janë siguruar vauçer me vlerë për shërbime konsulencë nga Asociacioni për menaxhment dhe konsulencë “MKA2000”, ndërsa për “Vajs aditiv” si të renditur të parë është siguruar taksë për pjesëmarrje në online trajnimin ndërkombëtar nga Fondi për novacione dhe zhvillim teknologjik.

“Veçanërisht jam e gëzuar se këtë vit patëm garë të realizuar me sukses dhe 32 aplikacione, që me të vërtetë është numër i madh nëse merren parasysh rrethanat dhe kriza me virusin korona që e përfshiu vendin tonë. Ju dëshirojmë sukses fituesve dhe shpresojmë se edhe këtë vit do të kthehemi me çmime nga gara regjionale, që edhe një herë do të dëshmojmë se jemi shtet që kujdeset për

ekonominë e gjelbër dhe sociale”, thotë Ivona Krstevska nga ARNO.

“Idetë e gjelbëra” është garë për zgjedhje të ideve/projekteve për idetë e gjelbra sipërmarrëse ose afariste, të cilat e promovojnë prodhimin tradicional të prodhimeve, mbështetje për bizneset e vogla lokale, të cilat shfrytëzojnë resurse nga komuniteti lokal dhe të cilat nxitin ide novative për zhvillimin e mjedisit jetësor. Përveç në vendin tonë gara organizohet edhe në: Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe në Greqi. Çdo vit nga tre përfaqësues nga çdo vend garojnë në garën regjionale. Katër përfaqësuesit të cilët do të fitojnë në garën regjionale fitojnë nga 10.000 ose 5.000 dollarë për realizimin e idesë në shtetin e tyre.



“Orë për orë” – banka kohore për zhvillimin e vlerave të komunitetit

Shoqata “Të rinjtë munden” me mbështetje të Fondit për novacione dhe zhvillim teknologjik (FNZHT) e përpunuan platformën digjitale „Orë për orë“ me të cilën shfrytëzuesit në vend të parave, do të mund ta shfrytëzojnë kohën e tyre si resurs për pagesë dhe këmbim të shërbimeve me persona tjerë.

“Rregulla e artë” e konceptit të bankës kohore është: Një orë nga koha ime është e barabartë me një orë të kohës tënde. Një orë nga shërbimi i dhënë dikujt fiton kredi nga një orë që të fitosh shërbim. Për një orë shërbim të pranuar “paguhet” kredi prej një ore.

Kjo vegël do t’u ndihmojë të rinjve që të bëhen qytetarë aktiv dhe të pavarur, të cilët besojnë se vetë ose të bashkuar

mund të bëjnë ndryshime pozitive në komunitet dhe në shoqërinë të tërësi. “Besojmë se të rinjtë mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e komuniteteve të veta dhe përmes aktivizmit rinor dhe social si vegla të fuqishme për ndryshim shoqëror, mund t’u përgjigjen nevojave të tyre në komunitet”, thonë nga ekipi i “Të rinjtë munden”.

Projekti “Orë për orë” është mbështetur nga FNZHT si pjesë e Kreatonit të dedikuar për idetë të cilat kanë për qëllim t’i lehtësojnë kushtet gjatë pandemisë së krijuar nga Covid-19.

Qytetarët e Gostivarit e morën fatin në duart e tyre

Me përkushtim shumë të madh, iniciativa joformale qytetare “**Stop Rusino – ajër i pastër për Gostivarin**” tashmë 40 ditë (deri te mbyllja e këtij numri të revistës) e mbajti platformën e ulur në hyrjen e deponies “Rusino” në afërsi të Gostivarit për të gjithë, përveç për kamionët e ndërmarrjes komunale nga Gostivari. Kërkesa e tyre kryesore është që të sanohet dhe dislokohet deponia dhe të caktohet lokacion i ri, ku do të ndërtohet deponia regjionale në pëlqim me standardet e BE.

Qytetarët, pjesëtarë të kësaj iniciative, më shumë herë kanë alarmuar për gjendjen e keqe me menaxhimin me mbeturinat, ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e qytetarëve. Disa herë protestuan në Gostivar, por pa ndonjë efekt të veçantë. Pika që gotën e derdhi ishin zjarret në korrik në deponinë “Rusino” për çka Gostivari u mbyt në tym dhe aromë të padurueshme. Për këtë, më 2 gusht, qytetarët të cilët ishin pjesë e kësaj iniciative vendosën platformë disa kilometra nga vetë deponia dhe vendosën 24 orë roje nga qytetarët.

“Të organizohet bllokadë prej 24 orëve nuk është punë e thjeshtë”, thonë aktivistët. Nevojiten njerëz që do të bëjnë kujdestari në turne edhe gjatë ditës edhe natën, që ta kontrollojnë transportin e mbeturinave. Prandaj, ata vazhdimisht u janë falënderues të gjithëve për mbështetjen dhe t’u bëjnë thirrje qytetarëve që t’u bashkohen. “Në këtë luftë për shëndet e presim mbështetjen nga të gjithë, pa dallim të religjionit, përkatësisë etnike dhe përcaktimit politik”, thonë nga iniciativa.

Aktivistët mund të jenë të kënaqur me veten nga arritjet e deritanishme. Është shuar zjarr i madh i deponisë dhe tani rregullisht mbushet me dhe, obligim që më parë anashkalohej nga operatorët. Janë vendosur kamera me çka do të identifikohen zjarrvënësit. Ajri në qytet është më i pastër, disa nga stacionet për matje tregojnë bile 22 herë ajër më të pastër pas “Stop Rusino – ajër i pastër për Gostivarin”.

“Këtu jemi që të gjejmë zgjidhje për “Rusino” sipas standardeve evropiane”, thonë aktivistët. “U bëjmë thirrje të gjitha partive, të gjithë deputetëve dhe këshilltarëve, të cilët i votuam nga Gostivari, që të japin mbështetje. Zgjidhja nuk gjendet te ne, por te institucionet. Ne jemi këtu vetëm që t’i nxitim institucionet”, thonë ata. Mbështetësit e iniciativës “Stop Rusino – ajër i pastër për Gostivarin” janë me mijëra dhe numri i tyre çdo ditë është në rritje. Ata janë mbështetje e madhe për gjetjen e zgjidhjeve për këtë problem të banorëve të Gostivarit.

Deponia “Rusino” duhet të jetë një nga gjashtë deponitë regjionale, të cilat do të ndërtohen në pëlqim me standardet e BE. Sipas dokumenteve strategjike për vendosjen e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina në nivel të shtetit, në “Rusino” do të deponohen mbeturinat nga gjithsej nëntë komuna nga regjioni i Pollogut.

Posle Stop Rusino



Pred Stop Rusino



Posle Stop Rusino



Pred Stop Rusino

“Dëshirojmë të mësojmë” – rekomanduan gjimnazistët gjatë protestës

Nxënësit e shkollave të mesme, prindërit dhe aktivistët e shoqërisë civile, të organizuar përmes Lidhjes së nxënësve të shkollave të mesme, më 31 gusht të këtij vitit protestuan kundër vendimit të Qeverisë për fillimin e vitit të ri shkollor me mësim online. “Dëshirojmë të mësojmë” brohoritën ata duke protestuar prej para ndërtesës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës deri te selia e Qeverisë. Pjesëmarrësit në këtë protestë kërkojnë që viti shkollor të fillojë me model të kombinuar të mësimi, me çka do t’i jepet rast çdo shkolle që vetë të vendos nëse do t’i hape dyert për nxënësit ose jo. Nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre, gjimnazistët do ta bojkotojnë mësimin.

Para protestës, përfaqësuesit e gjimnazistëve kishin takim me ministren e re të Arsimit dhe Shkencës, Mila Carovska. “Dëshirojmë që nesër, në mbledhjen e Qeverisë, të merren parasysh kërkesat tona dhe të merret vendim për model të kombinuar të mësimi”, deklaroi pas mbledhjes për mediat Blendi Hodai, kryetar i Lidhjes së nxënësve të shkollave të mesme. Ministria Carovska u ka premtuar se atje ku ka kushte, mësimi do të mund të fillojë me prezencë fizike duke mbajtur llogari për shëndetin publik.

Reagimet e gjimnazistëve ndaj vendimit për mësimin online u shkaktuan nga përvoja me mësimin e tillë prej muajit mars deri në fund të vitit të kaluar shkollor. Ata

mendojnë se mësimi nuk ka qenë cilësor dhe se i gjithë sistemi arsimor akoma nuk është i përgatitur për mësim të tërësishëm online. Krahas kësaj, ata shtojnë se duhet t’u jepet rast nxënësve të ri të shkollave të mesme që t’i njoftojnë profesorët e tyre në kontakt të drejtpërdrejtë. Këto janë një pjesë të arsyeve pse Lidhja e nxënësve të shkollave të mesme propozon model të kombinuar të mësimi.

Kësaj proteste i paraprinë shumë takime me autoritetet. Më 21 gusht ata patën takim me Qeverinë pas çka u paralajmërua se bashkarish do të bashkëpunojnë në avancimin dhe zbatimin më të mirë të modelit, sipas të cilit do të organizohet dhe zbatohet mësim në arsimin fillor dhe të mesëm në kushte të Covid-19. Qeveria e pranoi sugjerimin për përfshirje më të madhe të nxënësve të shkollave të mesme në përgatitjet për organizimin dhe zbatimin e modelit të pranueshëm që të arrihen zgjidhjet më të mira në interes të nxënësve dhe mësimdhënësve. Më 25 gusht ata morën pjesë në mbledhjen e Komisionit për sëmundje infektuese. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, e sqaroi procesin e vendosjes dhe lirim të masave restriktive në pëlqim me gjendjen epidemiologjike.



Maqedonia 2025 dhuroi pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësor

Me qëllim që të ndihmohet në mbrojtjen e personelit mjekësor në vend, në periudhën prill-maj, Maqedonia2025 organizoi online fushatë donatore “T’i mbrojmë punëtorët shëndetësor të cilët kujdesen për ne!”. Nga fillimi i pandemisë, vendi shënon rritje të rasteve të vërtetuara me Covid-19, ndërsa brengos fakti se nga numri i përgjithshëm të infektuarve, numër i madh janë punëtorët shëndetësor.

Mjetet e grumbulluara u shfrytëzuan për blerjen e pajisjes mbrojtëse mjekësore, e cila u dhurua atje ku ishte më e nevojshme. Në kuadër të fushatës, u dhuruan gjithsej 20 kuti intubimi në DPPU Honor dhe 700 litra mjete dezinfektuese në ISHP Shtëpia e shëndetit Shkup. Më tutje, 1750 maska mbrojtëse (KN95) u dorëzuan në më shumë institucione shëndetësore në vend, mes të cilave: ISHP Shtëpia e shëndetit Kumanovë (320), Poliklinika Idadia (130), Spitali i përgjithshëm i qytetit 8 Shtatori (450), Ordinanca Dr. Kristina (110), ISHP Shtëpia e shëndetit Shkup (30), Poliklinika Burushet (50), ISHP Dr. Maer (30), Asociacioni i specializantëve dhe mjekëve të rinj (250), ISHP KU Toariluc – Ortopedia (120), ISHP Spitali i specializuar për mjekësi geriatrike dhe paliative “13 Nëntor” – Shkup (30), Poliklinika Gjorçe Petrov (130) dhe ISHP Klinika universitare për radioterapi dhe onkologji (100). Po ashtu, grumbulluam mjete edhe për 1200 vizirë, të cilat u dhuruan në Asociacionin e specializantëve dhe mjekëve të rinj.

“Sepse miqtë në çaste të vështira njoftohen. Falë nga e gjithë zemra e Maqedonisë 2025 për donacionet dhe mbështetjen për punëtorët shëndetësor, të cilët janë në linjën e parë të frontit kundër Covid-19. Mbetshi me shëndet të mirë!” – deklaruan një pjesë të punëtorëve shëndetësor.

Përmes mbështetjes së anëtarëve tanë, bashkëpunëtorëve, partnerëve individual dhe qytetarëve të vetëdijshëm, kontribuam drejt sigurisë së atyre të cilët çdo ditë e rrezikojnë jetën e tyre për ne. Edhe një herë shprehim falënderim të madh deri te të gjithë të cilët dhuruan në suaza të kësaj online fushate për grumbullimin e mjeteve. Mungesa nga pajisjet mbrojtëse shëndetësore është e madhe, ndërsa rritja e paradokohshme e numrit të rasteve pozitive, ka nevojë për ndërjegjësim të madh të pjesëmarrjes qytetare.

Përmes aktivitetit të këtyre, Maqedonia2025 e realizoi një nga qëllimet e veta strategjike, e ky është avokimi i idealeve për shoqëri transparente, demokratike dhe inkluzive, që është mirë për qytetarët, zhvillimin ekonomik dhe për vendin.

Autor: Ema Jakimovska, Maqedonia2025



“Art” fushatë kundër mosrespektimit të masave për mbrojtje nga Covid-19

Shtip art aktivistët zbatuan disa aksione lidhur me sjelljen e papërgjegjshme të punëdhënësve, transportuese, punëtorëve dhe institucioneve gjatë periudhës së pandemisë. Në këtë mënyrë në fokus e vendosën papërgjegjësinë dhe mosrespektimin e masave për mbrojtje nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Shtabi i krizës.

“Përshkak të mosrespektimit të masave u bëmë dëshmitarë të përhapjes së infeksionit me Covid-19 dhe pamundësinë që të mbrohesh qytetarë të Shtipit dhe rrethinës. Dëshirojmë të përcjellim mesazh se sjellja e papërgjegjshme e ka çmimin e vet. Paraprakisht në autobusët voziteshin super heronjtë e Shtipit, por sot ata janë gjysmë të zbrazët, pasi që në autobusët përhapej infeksioni me virusin korona. Tani autobusët, në vend të super heronjve, e transportojnë virusin e Covid-19”, thonë aktivistët.

Aktivistët para fabrikave të tekstilit, para Komunës së Shtipit, në sheshin “Liria” dhe tregun e qytetit vendosën instalime me llogari fiskale, fatura dhe paragon blloqe, ku kishte të dhëna me numrin e të infektuarve dhe masat të cilat nuk janë respektuar si tregues se sjellja e papërgjegjshme dhe mosrespektimi i masave rezultojnë në numrin e rritur të infektuarve, të diagnostifikuarve, të hospitalizuarve dhe të vdekurve.

– Bëjmë apel deri te të gjithë qytetarët, punëdhënësit, transportuesit dhe institucionet, t’i respektojnë masat, të jenë të përgjegjshëm, solidar, në lartësinë e detyrës dhe ta mbrojnë shëndetin kolektiv në Shtipin tonë, thonë Shtip art aktivistët.



QYTETARËT PËR NDRYSHIME

Kryeredaktor: Gonce Jakovleska

Redaktor: Aleksandra Siljanovska

Adresa e Botuesit: Rr. Nikolla Parapunov nr. 41a, f.p 55, 10160 Shkup

Tel: ++ 389 (0)2 3065 381

e-mail: helpdesk@civicamobilitas.mk



„Qytetarët për ndryshim“ e boton programi Civica Mobilitas i mbështetur financiarisht nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), implementuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG nga Suedia.

Artikujt e botuar në këtë revistë shprehin pikëpamjet e autorëve dhe/ose organizatave që kontribuojnë në revistë, por jo ato të Ambasadës Zvicerane/Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ose ato të organizatave implementuese: NIRAS, MCMS ose FCG.

www.civicamobilitas.mk